



REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
ELBASAN

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli: “Konsultim për zgjedhjen e komisioneve të këshillit”

Propozuesi: Kryetari i Këshillit Bashkiak.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim ka për qëllim të përfshijë grupet shoqërore në vendimmarrje lidhur me krijimin e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak Elbasan.

Sqarime: Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi zgjedhjen e komisioneve të këshillit.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet më datë 30.08.2023 ora 11:00 në ambjentet e “Hotel Imperial”.

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Kryetar i Këshillit Bashkiak,
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Elbasan, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik në terren synon për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi zgjedhjen e komisioneve të këshillit.
	Komisionet e Këshillit janë të Përhershëm ose të Përkohshëm dhe përbëhen nga Këshilltarë Bashkiakë. Komisionet e Përhershme kanë juridiksion të vazhdueshëm mbi një apo disa çështje që ka lidhje me funksionet e Bashkisë.



<p>Përshkrimi i çështjes.</p>	<p>Komisionet e Përhershëm të Këshillit janë komisione statutorë (të kërkuar nga ligji) dhe jo-statutorë. Komision statutorë është Komisioni i Mandateve. Komisionet e Përhershëm jostatutorë janë komisionet që përcaktohen nga Këshilli Bashkiak sipas fushave të veprimtarisë së Bashkisë dhe prioriteteve të Këshillit.</p> <p>Objekt i punës së Komisioneve është diskutimi i projekteve, rezolutave, deklaratave, politikave dhe mbikqyrja e punës së Ekzekutivit të Bashkisë, të institucioneve, ndërmarrjeve dhe agjencive në vartësi të Bashkisë, si dhe marrja e informacionit, mendimeve të tyre, si dhe për të dëgjuar komentet, propozimet, vërejtjet e qytetarëve, shoqërisë civile dhe biznesit. Lidhur me numrin dhe përbërjen e komisioneve Këshilli ka propozuar një riorgranizim të tyre duke krijuar 13 Komisione, duke përfshirë Komisionet statutorë të kërkuara nga ligji Komisionin e Mandateve dhe Komisionin e Financë-Buxhetit, ndërsa Komisionet jo statutorë janë organizuar nga Këshilli Bashkiak sipas fushave të veprimtarisë së Bashkisë dhe prioriteteve të Këshillit, bazuar në Nenin 26 të rregullores. Propozohet ndryshimi i numrit të Komisioneve të Përhershme të Këshillit.</p> <p>Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi zgjedhjen e komisioneve të këshillit.</p>
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në ditën e mbajtjes së takimit.</p>
<p>Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme</p>	<p>Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit: Ndryshime dhe/ose alternativat e mundshme në zgjedhjen e komisioneve të këshillit.</p>



<p>Dokumentacioni, në lidhje me çështjen që konsultohet.</p>	<p>Krijimi i 13 (trembëdhjetë) Komisioneve të Përhershme të emëruara si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Komisioni i nxitjes së sipërmarrjes (7 anëtarë)2. Komisioni i planifikimit urban dhe zhvillimit të territorit (7 anëtarë)3. Komisioni i turizmit, trashëgimisë historike dhe kulturore (7 anëtarë)4. Komisioni i financave, buxhetit dhe aseteve publike (7 anëtarë)5. Komisioni i mjedisit, bujqësisë, veterinarisë, pyjeve, menaxhimit të ujrave, mbrojtjes së konsumatorit dhe transparencës (7 anëtarë)6. Komisioni për përafrimin e politikave të BE dhe bashkëpunimit me donatorët e huaj (7 anëtarë)7. Komisioni i shërbimeve dhe strehimit social, shëndetësisë dhe barazisë gjinore (7 anëtarë)8. Komisioni i arsimit (7 anëtarë)9. Komisioni për rininë, sportet dhe rekreacionin (7 anëtarë)10. Komisioni për çështjet ligjore (7 anëtarë)11. Komisioni i rendit publik (7 anëtarë)12. Komisioni për mbrojtjen civile (7 anëtarë)13. Komisioni i mandateve dhe rregullores (3 anëtarë)
--	--